



KPPP.nr. 650/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit Sh.p.k “P...”, me adresë fshati .... – Komuna e Gjilanit, NRB: ....., me pronar H.Xh. , përfaqësuar sipas autorizimit nga N.Z. , kundër debitorit Dogana e Republikës së Kosovës, të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.157/2021 të datës 12.04.2021, të Përbaruesit Privat Sefer Sh. Arifi, me seli në Gjilan, jashtë seancës me datën 04.11.2022, merr këtë:

#### A K T V E N D I M

I.PRANOHET prapësimi i debitorit Dogana e Republikës së Kosovës, ANULOHET urdhri për lejimin e përbarimit P.nr.157/2021 të datës 12.04.2021, të lëshuar nga përbaruesi Privat Sefer Sh. Arifi nga Gjilani.

II.PËRFUNDOHET procedura përbarimore e kreditorit Sh.p.k “P...”, me adresë fshati .... – Komuna e Gjilanit ndaj debitorit Dogana e Republikës së Kosovës, sipas urdhit përbarimor P.nr.157/2021 të datës 12.04.2021, të Përbaruesit Privat Sefer Sh. Arifi në Gjilan.

#### A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Sh.p.k “P...”, me adresë fshati .... – Komuna e Gjilanit, ka lëshuar urdhër me të cilin e ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarimor – vendimit me nr. 07.4/961 dt. 25.06.2014, të Doganës së Kosovës, me të cilin ka obliguar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri ti paguaj kreditorit shumën e borxhit në vlerë prej 5.500.00 euro, në bazë të dokumentit përbarues si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës përbarimore, sipas udhëzimit administrativ për tarifatat e Përbaruesit Privat, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

Kundër urdhit për lejimin e përbarimit, në afatin ligjor, prapësim ka paraqitur debitori. Në prapësim ka theksuar se e kundërshton në tërësi urdhrin përbarimor të lëshuar nga Përbaruesi Privat duke i propozuar gjykatës që ta aprovon prapësimin dhe ta anulon urdhrin në fjalë si të pa bazuar për faktin se i njëjti është në kundërshtim me dispozitën e nenit 36 të LPP –së, pasi që nuk përmban vërtetimin për përbarueshmëri.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka deklaruar se aktvendimi si dokument përmbartimor i plotëson të gjitha kushtet e parapara me nenin 27 të LPP –së, dhe pretendimi i debitorit është i pa bazuar dhe bëhet vetëm me qëllim zvarritjen e procedurës. Ka shtuar se vendimi si dokument përmbartimor në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, është dokument origjinal dhe i ka të gjitha tiparet e përmbartueshmërisë në kuptim të nenit 21 dhe 22 lidhur me nenin 27 të LPP –së. Andaj, i ka propozuar gjykatës ta refuzoj në tërësi këtë prapësim si të pa bazuar, ndërsa urdhri të mbetet në fuqi, si urdhër i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i bazuar, nga këto arsye:

Gjykata vlerëson se propozimi i kreditorit është ushtruar duke u bazuar në vendimin e Doganës së Republikës së Kosovës, me të cilin vendim është lejuar kthimi i mjeteve në xhirollogarinë, për subjektin Sh.p.k “P...” Gjilan këtu kreditori, që ka të bëjë me aktvendimin e Doganës së Kosovës, 05.2.1/961 dt. 26.10.2011 dhe aktvendimin 04.2.3.1/700 dt. 31.08.2011 të Komisionit për kundërvajtje doganore, në emër të gjobës administrative shumë prej 5.500.00 euro.

Pas analizimit dhe vlerësimit të urdhrin për përmbartim dhe shkresave të lëndës, gjykata gjen se urdhri për përmbartim, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Sefer Sh. Arifi është lejuar mbi bazën e një dokumenti – akti administrativ cili nuk ka tipare të dokumentit përmbartimor, respektivisht nuk është i përshtatshëm për përmbartim, konform Nenit 24 dhe 36 të LPP-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, vendimi me nr. 07.4/961 dt. 25.06.2014, i Doganës së Kosovës, nuk i përmbush tiparet e përmbartueshmërisë konform Nenit 27 të LPP-së dhe nuk mund të jetë i përmbartueshëm sipas Nenit 24 par. 3 dhe nenit 36 të LPP-së.

Me dispozitën e Nenit 24 par.3 të LPP-së, është paraparë se “*Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbartimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë*”. Ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së parashihet se “*dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes*”.

Ndërsa, me nenin 36 të LPP –së, është paraparë se: “*Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmëris për përmbartueshmëri.*”

Gjykata, duke vlerësuar urdhrin për përmbarim – dokumentin përmbarimor, gjeti se propozimi për përmbarim bazohet mbi vendimin e Doganës së Republikës së Kosovës nr. 07.4/961 dt. 25.06.2014 i cili nuk i plotëson kushtet për lejueshmërinë e përmbarimit. Vendimi administrativ në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk përmban klauzolën e përmbarueshmërisë. Andaj, gjykata gjen se vendimi në fjalë, nuk mund të trajtohet si titull përmbarues, pasi që i njëjti nuk përmban kushtet të cilat janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit, prandaj sipas vlerësimit të kësaj gjykatë nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me nenin 36 paragrafi 1, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se dokumenti përmbarues, mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lëshuar urdhrin përmbarimor, nuk i përmban tiparet e përmbarueshmërisë, konform Nenit 36 par. 1 të LPP-së, pasi që nuk përmban klauzolën e përmbarueshmërisë

Andaj, gjykata vlerëson se dokumenti përmbarimor në bazë të cilit është lëshuar urdhri nga përmbaruesi privat, nuk i plotëson kushtet për përmbarim që duhet t'i ketë dokumenti përmbarimor, prandaj ka vendosur si në dispozitiv, duke shfuqizuar Urdhrin e lejuar nga Përmbaruesi Privat dhe ka përfunduar procedurën përmbarimore në këtë çështje.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë pranoi prapësimin e debitorit.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.650/22, datë 04.11.2022

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.